



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 35/2010
Prishtinë, 28. 09. 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Mursel Haljilji, Fatmir Rexhepi, Qamile Morina, Zef Morina, Adem Salihaj dhe Mufëra Şinik.

Munguan: Adem Grabovci dhe Kaqusha Jashari,

Pjesëmarrës të tjerë: Sabit Gashi, Besim Veselaj- MEM; Haxhi Gashi- USAID; Driton Selmanaj– KDI, Ibrahim Krasniqi konsulent i Komisionit;

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të datës 21 dhe 22.09.2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.03/L-185 për rregullatorin e energjisë;
4. Të ndryshme

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i Procesverbaleve të datës 21 dhe 22.09.2010;

Procesverbalet të mbledhjes së 21 dhe 22.09.2010 u miratuan me vërejtjet e deputetes Qamile Morina.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.03/L-185 për rregullatorin e energjisë;

Kryetarja –Theksoi se për këtë Projektligj është raportues Ethem Çeku.

Ethem Çeku -Tha që nuk kam çka të shtoj të gjithë kemi qenë grupin punës. Edhe pse mbaje një opinion më ndryshe dhe pse kam qenë kryesues i grupit punës. Çështjet janë rreth tenderimit dhe ZRRE-së, kam mendur që së paku të kemi mbështetje që të kemi një ndarje të përgjegjësive, në fund institucionet të menaxhojnë suksesshëm rreth rregullatorit të energjisë. Mirëpo ka qenë vendim i shumicës. Në fund është kërkuar një komente të Kreut të II-të nën paragraf 6 Amendamenti 3 nga ZRRE-ja.

Armend Ademaj (Njësia mbështetëse e Komisionit) – njoftoi Komisionin se është një kërkesë e datës së sotme nga ZRRE-ja të paragrafi 6, i Amendamenti 3, duhet të fshihet dhe të mbetet paragrafi 6 i Nenit 4 si në Projektligj. Sepse amendamenti është konfuz dhe hap shumë dilema, ku nuk mund të mundëson anëtarëve aktual të Bordit të ZRRE-së, të riemërohen edhe për një mandat.

Haxhi Gashi (USAID) – tha se amendamenti 3 pjesa ku referohet paragrafi 6 është shumë i qartë mirëpo ka keq interpretim sepse edhe anëtarëve aktual të Bordit të ZRRE-së edhe të tjerëve mundësohet riemërimi edhe për një mandat.

Komisioni vendosi që amendamenti 3 paragrafi 6 i Nenit 4 të ndryshohet si vijon:

6. Anëtarët e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë të cilët janë riemëruar në pozitën e tyre sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 2004/9) do të shërbejnë në pozitën e anëtarit të Bordit deri në përfundimin e mandatit të tyre aktual mirëpo nuk mund të riemërohen përsëri sipas këtij ligji. Anëtarët të cilët janë emëruar në Bord sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 2004/9) dhe të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë duke shërbyer mandatin e tyre të parë, do të shërbejnë në pozitën e anëtarit të Bordit deri në përfundimin e atij mandati dhe mund të riemërohen një herë sipas këtij ligji.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente të Projektligjit Nr.03/L-185 për rregullatorin e energjisë për miratim të mëtutjeshme në Komisionet e përhershme.

6. Të ndryshme

(i) Monitorimi i Ligjit nr. 2002/7 për telekomunikacion

Kryetarja – kërkoj nga kryesuesi i Grupit punues z.Morina që në mbledhjen radhës të komisionit të hynë në rend të ditës Raporti për Monitorimin ligjit nr.2002/7 për telekomunikacion.

Zef Morina – theksoj se Raporti është i gatshëm dhe në mbledhjen e radhës do të diskutohet.

Komisioni në mbledhjen e radhës të diskutoj Monitorimi i Ligjit nr.2002/7 për telekomunikacion

(ii) Strategjia minerare e Kosovës 2001/2015

Kryetarja – njoftoi deputetet se kemi materialin e Strategjisë minerare e Kosovës për periudhën 2010/2015 dhe Njoftimi për rikonstruimin e Kombinatit TREPÇA, kërkoj të formohet një Grup punues.

Ethem Çeku – e përkrahu propozimin e Kryetares dhe propozoj që të formohet grupi punues dhe të diskutohet për problemet ekonomike, politike dhe juridike.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

Përfundim

Formohet Grupi i punës për shqyrtimin e Strategjisë minerare e Kosovës për periudhën 2010/2015 në këtë përbërje: Myzejene Selmani, Ethem Çeku, Mursel Haljilji, Sala Berisha – Shala, Qamile Morina, Fatmir Rexhepi dhe Zef Morina.

(iii) Grupet punuese për Projektligjet në procedurë

Kryetarja – njoftoi Komisionin se brenda kësaj jave do të përfundojnë edhe dy Projektligje, ai për energjinë elektrike dhe për mbrojtjen e konkurrencës. Po ashtu caktoj deputetet Mursel Haljilji dhe Adem Salihaj, në Grupin punues për Projektligjet markat tregtare, dizajn industrial dhe metrologji, të cilin Grup e udhëheq z. Fatmir Rexhepi.

(iv) Projektligji për Plot.Ndrysh. të Ligjit nr. 03/L-210 për Shoqëritë tregtare

Kryetarja – njoftoi se ky Projektligj do të kalojë në lexim të dytë pas vërejtjeve nga USAID të cilët kanë kërkuar afat prej dy javësh për shkak se do të del një draft i konsoliduar Projektligjit së bashku me Ligjin e ndryshuar për Shoqëritë tregtare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani